

## Mursel (Hajrullah) Buqa

(23.04.1937, shqiptar nga Budakova/Budakovo, komuna e Suharekës/Suva Reka, bujk, tetë fëmijë)

Murseli me familje e kanë braktisur shtëpinë në Budakovë/Budakovo më 26.09.1998. Gratë dhe fëmijët shkuan në Mushtishtë/Muşutište, ndërkaq Murseli me djalin Salihun u strehuan në një vend jo shumë larg fshatit, të quajtur *Livadhet e Lakes/Ljakine livade*, në afërsi të **Budakovës/Budakovo**. Një ditë më vonë, më 27.09.1998, u kthyen në fshat që të shihnin çfarë kishte ndodhur me shtëpinë e tyre. Në çastin kur iu afrua shtëpisë, Murselin e kanë zënë pjesëtarë të forcave serbe. Salihu, i cili ishte i fshehur në afërsi të shtëpisë, ka dëgjuar se si pjesëtarë të forcave serbe e keqtrajtonin dhe e rrihnin Murselin deri në mëngjesin e ditës tjetër [28.09.1998], kur e ekzekutuan me katër plumba afër mullarit të sanës. Pastaj, ia vunë zjarrin sanës dhe shtëpisë së familjes Buqa. Pas pesë ditësh, vëllai i Murselit, Veseli, e ka gjetur trupin e Murselit. Me ndihmën e banorëve të fshatit, e ka varrosur në afërsi të shtëpisë së Murselit, ku prehet edhe sot.

**Burimet:** deklarata B.B, FDH-11168; J. Osmani, *Krimet...*, I, 344; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838; KMDLNJ, *Buletini*, num.9, tetor-dhjetor 1998, 124, FDH-23857.

## Qazim (Brahim) Kololli

(1941, shqiptar nga Budakova/Budakovo, komuna e Suharekës/Suva Reka, bujk, pesë fëmijë)

Qazimi me komshinj e kanë braktisur Budakovën/Budakovo më 27.09.1998. U strehuan në pyllin e afërt. Bashkëshortja dhe vajzat e tij ishin arratisur më herët në Gjakovë/Đakovica. Një ditë më vonë, më 28.09.1998, Qazimi u kthye në fshat që ta gjente të birin. Në shtëpinë e tij i ka gjetur katër pjesëtarë të forcave serbe, të cilët e rrahën dhe, pastaj, e lëshuan. Qazimi sërish u kthye në pyll. Po atë ditë, rreth orës 18:00, forcat serbe filluan të shtënin me armë zjarri drejt vendit ku ishin strehuar Qazimi me komshinj. Të gjithë u shpërndanë në anët e ndryshme. Qazimin e kanë parë të gjallë për herë të fundit përderisa ikte me vrap drejt *Lagjes*

*së Kepëve* në **Budakovë/Budakovo**. Pas dy ditësh, banorët e fshatrave përreth e kanë gjetur trupin e pajetë të Qazimit në pyllin përmbi *Mëhallën Buzhala* [Budakovë/Budakovo]. E kanë varrosur po atë ditë në varrezat e fshatit.

**Burimet:** deklarata A.K, FDH-11167; deklarata N.N, FDH-3656; deklarata N.N, FDH-3655; deklarata N.N, FDH-3654; KMDLNJ, *Buletini*, num.9, tetor-dhjetor 1998, 114, FDH-23857; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.6D00701, FDH-35931; fotografi, FDH-19086.

## Rexhë (Sali) Kokollari

(13.05.1928, shqiptar nga Budakova/Budakovo, komuna e Suharekës/Suva Reka, bujk, gjashtë fëmijë)

Rexha me familje e kanë braktisur **Budakovën/Budakovo** më 27.09.1998. U strehuan në pyll, te vendi i quajtur *Maja e Ahishtës/Bukvin vrh*, ku strehim kishin gjetur edhe banorë të fshatrave përreth. Pas dy ditësh, më 29.09.1998, forcat serbe e filluan bombardimin e *Majës së Ahishtës/Bukvin vrh*. Kjo shkaktoi panikun në mesin e refugjatëve dhe ata u arratisen me vrap në të gjitha anët. Kur bombardimi pushoi, familjarët e Rexhës u mblodhën sërish, por ai mungonte. Dy ditë më vonë, pjesëtarë të UÇK-së i kanë lajmëruar djalit të Rexhës, Milaimit, se e kishin gjetur trupin e pajetë të Rexhës në një livadh përmbi shtëpinë e tyre. Po atë ditë, Milaimi me disa banorë e kanë varrosur Rexhën në varrezat e fshatit. Pas luftës, ekspertët ndërkombëtar të mjekësisë ligjore i kanë zhvarrosur mbetjet mortore të Rexhës dhe i kanë çuar në Institutin për Mjekësinë Ligjore në Rahovec/Orahovac. Pas obduksionit, në muajin gusht të vitit 2000, familjarët i kanë marrë mbetjet mortore të Rexhës dhe i kanë varrosur në varrezat e Budakovës/Budakovo.

**Burimet:** deklarata B.K, FDH-11169; deklarata N.N, FDH-3655; KMDLNJ, *Buletini*, num.9, tetor-dhjetor 1998, 118, FDH-23857; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.6D00701, FDH-35931.